

EPPC Albania kërkon një **Përfaqësues Shitjesh HoReCa**, për klientin e saj, një kompani që operon në sektorin e shitjeve, distribucionit, import/eksportit.

Përgjegjësitë kryesore:

- Vendos dhe mban kontakte me bizneset private që operojnë në zonën e caktuar gjeografike nën përgjegjësi si dhe me bizneset e tjera në zhvillim;
- Komunikon dhe prezanton gjithë produktet dhe shërbimet e kompanisë tek klientela në zonën përkatëse;
- Identifikon, shqyrton dhe plotëson nevojat e klientëve bazuar në strategjinë komerciale të kompanisë.
- Suporton klientin në raste problematike që mund të shfaqen duke ofruar zgjidhje të ndryshme;
- Kryen vizita dhe kontakte të rregullta duke përfshirë dhe thirrjet telefonike me gjithë bizneset HoReCa dhe filialet e tyre;
- Siguron informacion të drejtpërdrejtë dhe të menjëhershëm për klientët e tij mbi produktet e reja dhe shërbimet e kompanisë;
- Ruan njohuri të plotë dhe të thellë për portofolin e klientëve që ka në përgjegjësi;
- Identifikon kompanitë ekzistuese konkurrense si dhe strukturën e tyre dhe monitoron së afërmi lëvizjet, produktet, çmimet dhe efektshmërinë e shërbimeve të tyre;
- Garanton raportim në kohën e duhur dhe me saktësi tek Supervizori përkatës ose departamentet e tjera respektive në rast të shfaqjes së ndonjë problematike lidhur me ndonjë nga klientët, duke monitoruar së afërmi progresin e duhur deri në një zgjidhje finale;
- Përgatit dhe paraqet në mënyrë të përditshme, periodike dhe sipas rastit raporte në lidhje me shitjet dhe klientelën e mbuluar për sektorin e zonës ku ai është përgjegjës;
- Monitoron procesin e porosive dhe bashkëpunon ngushtë me gjithë departamentet përgjegjëse deri në mbërritjen e tyre tek klienti.

Kërkesat për këtë pozicion janë:

- Diplomë Universitare e preferueshme në **Administrim Biznesi apo fusha të ngjashme;**
- **Eksperienca e punës e preferueshme 2-3 vite ne HoReCa;**
- Preferohet të ketë njohuri të gjuhës angleze;
- **Aftësi shumë të mira negocimi, prezantimi dhe komunikimi;**
- Aftësi shumë të mira planifikuese dhe monitoruese.

Si të aplikoni:

Për të aplikuar për këtë mundësi punësimi, ju lutemi dërgoni CV-në tuaj në linkun që vijon:

<https://aplikim.eppc.al>

Ju do të kontaktoheni vetëm në qoftë se CV-ja juaj do të kualifikohet.